

## TERMS OF REFERENCE (ToR)

**Institucioni:** Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

**Drejtoria Përgjegjëse:** Drejtoria e NVM-ve, Projekteve dhe Eksporteve

**Lloji i Angazhimit:** Ekspert i Jashtëm (Person Fizik / Person Juridik)

**Kohëzgjatja e Kontratës:** 4 muaj

**Vendndodhja:** Tiranë / Aktivitet në terren sipas nevojës

**Forma e Kontratës:** Kontratë shërbimi

**Lënda:** *Angazhimi i një Eksperti të Jashtëm për Mbështetjen e NVM-ve në Akses në Financë, Fonde të Bashkimit Europian dhe Instrumente të Financimit Ndërkombëtar*

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në përputhje me misionin e saj për mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit, rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM), si dhe promovimin e ndërkombëtarizimit dhe aksesit në financë, ka identifikuar nevojën për forcimin e kapaciteteve teknike në fushën e aplikimeve për fonde dhe instrumente financiare të Bashkimit Europian dhe donatorëve ndërkombëtarë.

Në vitet e fundit, programet e financimit të Bashkimit Europian dhe mekanizmat e mbështetjes financiare për bizneset janë bërë gjithnjë e më komplekse në aspektin teknik, metodologjik dhe procedural. Proceset e aplikimit kërkojnë ekspertizë të avancuar në:

- zhvillimin e projekt-propozimeve;
- hartimin e matricave logjike;
- strukturimin e planeve të zbatimit;
- ndërtimin e indikatorëve të performancës;
- hartimin e buxheteve sipas standardeve të BE-së;
- dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik e financiar.

Aktualisht, Drejtoria e NVM-ve, Projekteve dhe Eksporteve mbulon një gamë të gjerë funksionesh operacionale dhe strategjike që lidhen me mbështetjen ndaj NVM-ve, koordinimin e projekteve, aktivitetet e eksportit dhe ndërkombëtarizimit, si dhe menaxhimin e proceseve të ndryshme institucionale. Për shkak të volumit të lartë të angazhimeve dhe kompleksitetit të shtuar të programeve financiare ndërkombëtare, drejtoria nuk disponon kapacitete të dedikuara dhe të specializuara për të mbuluar në mënyrë të plotë komponentin teknik të zhvillimit të aplikimeve për fonde.

Gjithashtu, kërkesa në rritje nga bizneset shqiptare për asistencë konkrete në aksesin ndaj fondeve dhe programeve financiare ndërkombëtare ka evidentuar nevojën për mbështetje të specializuar teknike dhe metodologjike, me qëllim:

- rritjen e cilësisë së aplikimeve;
- rritjen e përthithjes së fondeve;

- standardizimin e proceseve të aplikimit;
- dhe ndërtimin e instrumenteve praktike të përdorshme nga bizneset dhe AIDA.

Në këtë kuadër, konsiderohet i domosdoshëm angazhimi i një eksperti të jashtëm me eksperiencë të provuar në fushën e fondeve të Bashkimit European, aksesit në financë dhe zhvillimit të projekteve, i cili do të kontribuojë në:

- ofrimin e asistencës teknike të specializuar;
- transferimin e njohurive;
- ndërtimin e metodologjive standarde;
- dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të AIDA-s.

### **OBJEKTIVI I ANGAZHIMIT**

Objektivi i përgjithshëm i këtij angazhimi është forcimi i kapaciteteve të NVM-ve shqiptare dhe i kapaciteteve institucionale të AIDA-s në drejtim të aksesit në financë dhe përthithjes së fondeve të Bashkimit European dhe donatorëve ndërkombëtarë.

### **OBJEKTIVAT SPECIFIKE**

Eksperti i jashtëm do të kontribuojë në:

- Rritjen e kapaciteteve të NVM-ve për të identifikuar dhe aplikuar në programe financimi;
- Ofrimin e asistencës teknike për hartimin e aplikimeve konkurruese;
- Përmirësimin e cilësisë së projekt-propozimeve;
- Standardizimin e dokumentacionit teknik dhe metodologjik të përdorur nga AIDA;
- Ndërtimin e instrumenteve praktike dhe udhëzuesve për bizneset;
- Forcimin e njohurive mbi kriteret dhe procedurat e financimit të BE-së;
- Krijimin e modeleve standarde për përdorim institucional afatgjatë.

### **FUSHA E SHËRBIMIT DHE DETYRAT KRYESORE**

Eksperti do të jetë përgjegjës për realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:

#### *1) Trajnim dhe Mentorim për NVM-të*

Eksperti do të organizojë dhe zhvillojë aktivitete trajnuese dhe mentorim për bizneset shqiptare lidhur me:

- mekanizmat e aksesit në financë;
- fondet dhe grantet e Bashkimit European;
- instrumentet financiare hibride;
- kreditë e buta;
- programet e donatorëve ndërkombëtarë.

Aktivitetet do të përfshijnë:

- sesione informuese;
- workshope praktike;
- trajnime tematike;
- konsultime individuale;
- mentorim të drejtpërdrejtë për bizneset.

Në kuadër të mentorimit, eksperti do të ndihmojë bizneset në:

- identifikimin e mundësive të financimit;
- konceptimin e projekt-ideve;
- formulimin e objektivave;
- strukturimin e projekt-propozimeve;
- përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe financiar.

## 2) *Asistencë Teknike për Aplikime në Fonde dhe Grante*

Eksperti do të ofrojë asistencë teknike të specializuar për:

hartimin e aplikimeve;

strukturimin metodologjik të projekteve;

përgatitjen e matricave logjike;

ndërtimin e planeve të zbatimit;

formulimin e indikatorëve të performancës;

hartimin e strukturës buxhetore;

përgatitjen e planeve të monitorimit dhe raportimit.

Eksperti gjithashtu do të mbështesë:

identifikimin e thirrjeve të përshtatshme për bizneset shqiptare;

interpretimin e kriterëve të aplikimit;

verifikimin e përputhshmërisë teknike dhe administrative të aplikimeve.

## 3) *Sigurimi i Përputhshmërisë me Kërkesat e Bashkimit European*

Eksperti do të ofrojë mbështetje në:

interpretimin e kriterëve të pranueshmërisë;

standardet teknike dhe financiare të programeve të BE-së;

strukturimin e dokumentacionit sipas kërkesave të donatorëve;

procedurat e raportimit dhe monitorimit.

Gjithashtu do të asistojë në:

harmonizimin e aplikimeve me standardet ndërkombëtare;

reduktimin e gabimeve procedurale;

dhe përmirësimin e cilësisë teknike të aplikimeve.

#### 4) *Zhvillimi i Materialeve dhe Instrumenteve Standarde*

Eksperti do të zhvillojë një paketë të plotë materialesh standarde për përdorim nga AIDA dhe bizneset shqiptare, duke përfshirë:

**Manuale dhe Udhëzues:** manual për akses në financë dhe fondet e BE-së; Guidë praktike për aplikime në grante; Udhëzues për strukturimin e projekteve.

**Template dhe Instrumente Praktike:** modele aplikimi; modele buxhetesh; matrica logjike; checklist për aplikime; modele raportimi.

**Materiale Trajnimi:** prezantime standarde; materiale informuese; materiale metodologjike; raste praktike dhe shembuj aplikimesh.

### **REZULTATET E PRITSHME**

Eksperti do të dorëzojë:

*Dokumente Teknike:* Raport fillestar metodologjik; Plan pune dhe metodologji zbatimi; Manuale dhe guida praktike; Template standarde aplikimi

*Materiale Trajnimi:* Prezantime; materiale informuese; modele praktike aplikimi; raporte; raporte progresi periodike; raport përfundimtar me rekomandime.

### **KUALIFIKIMET DHE EKSPERIENCA E KËRKUAR**

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

**Minimumi 5 –7 vite eksperiencë profesionale në:** zhvillim biznesi; akses në financë; programe dhe fonde të BE-së.

**Eksperiencë të provuar në:** përgatitjen e aplikimeve për financim; menaxhimin e projekteve të financuara nga BE; projekte të donatorëve ndërkombëtarë.

**Njohuri të avancuara mbi:** instrumentet financiare të BE-së; procedurat e aplikimit; standardet e raportimit dhe monitorimit.

**Eksperiencë në:** hartim dokumentacioni teknik; zhvillim manualesh dhe guidash; trajnime dhe facilitim.

**Aftësi shumë të mira:** analitike; komunikimi; organizimi; koordinimi institucional.

## **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaj;

Forma e angazhimit: Kontratë shërbimi;

Pagesa do të kryhet mbi bazën e deliverables dhe raporteve të miratuara.

## **MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

**Eksperti do të raportojë pranë:** Drejtorisë së NVM-ve, Projekteve dhe Eksporteve – AIDA

Monitorimi do të realizohet mbi bazën e: planit të punës; objektivave të dakordësuara; deliverables të miratuara; rezultateve të arritura.

Në përfundim të angazhimit pritet:

- Rritje e kapaciteteve të NVM-ve shqiptare për aplikim në fonde;
- Përmirësim i cilësisë së aplikimeve;
- Rritje e potencialit të përthithjes së fondeve;
- Standardizim i proceseve të aplikimit;
- Krijim i instrumenteve praktike për përdorim institucional;
- Forcim i kapaciteteve teknike të AIDA-s në fushën e aksesit në financë dhe projekteve të BE-së.

## **Dosja e aplikimi duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtme:**

- Jetëshkrimi/Curriculum Vitae;
- Dokumentacioni që vërteton eksperiencën të mëparshme në punë të ngjashme, si kontrata, etj;
- Fotokopje ID/Pasaportë;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Buxhet i detajuar për shërbimin.

**Kjo thirrje do të qëndrojë e hapur deri më 17.06.2026, ora 16:30.**

Procedura e Përzgjedhjes

Ofertat e paraqitura do të shqyrtohen nga një komision i përbërë nga 3 (tre) anëtarë.

Fituesi do të shpallet më datë 19.06.2026.

Gjatë përzgjedhjes do të merren parasysh:

- eksperiencia profesionale;
- aftësia e tij për të hartuar dokumentacion teknik;
- eksperiencë në organizimin e trajnimeve;
- njohuri mbi instrumentat financiare të BE-së;

Aplikimi dhe dorëzimi i dosjes së aplikimit me të gjitha dokumentat e cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë ose në adresën zyrtare të e-mailit: [info@aida.gov.al](mailto:info@aida.gov.al).